

EDUARD NDRECA



Datëlindja: 11.02.1983

Vendlindja: Kalivaç, Lezhë

Email: Eduard.Ndreca@parlament.al

Jetëshkrimi:

Eduard Ndreca ka përfunduar studimet në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, Universiteti Luigj Gurakuqi, Dega Histori-Gjeografi, (2001-2005). Në vitin 2010 ka mbaruar Masterin e Nivelit të Dytë në Politikë e Jashtme dhe Diplomaci, pranë Universitetit UFO në Tiranë, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Dega e Shkencave Politiko-Administrative. Në vitin 2020 ka marrë gradën shkencore “DOKTOR” në Histori pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti Histori-Filologji.

Nga viti 2019 e në vazhdim është Kryetar i Këshillit të Qarkut Lezhë. Njëkohësisht dhe pedagog i jashtëm pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Pedagog i brendshëm pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” (2017-2019) si dhe Anëtar dhe njëkohësisht kryetar i Bordit të Administrimit në këtë Universitet (2016-2019). Ka qenë gjithashtu Prefekt i Qarkut Lezhën (2016-2017).

Ka qenë kryetar i Partisë Socialiste të qytetit të Lezhës (2012-2016) dhe nga (nëntori 2018 e në vazhdim) Kryetar i Partisë Socialiste të Rrethir Lezhë.